



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:087157

Datë: 13.02.2023

Numri i dokumentit: 03972658

CT.nr.05/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni civil, Gjyqtari Jeton Zymeri, në çështjen juridike trashëgimore të propozueses B. R., të cilën e përfaqëson Ruzhdi Maloku avokat nga Vushtrria rruga “Hasan Prishtina” nr.78, pas vdekjes së trashëgimlënësit A. R.ish nga fshati P. Komuna e V., duke vendosur sipas propozimit për shqyrtimin e trashëgimisë, me datë 13.02.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Në tërë masën trashëgimore në vijim, të lënë pas vdekjes së të ndjerit-trashëgimlënësit A Z. R., ish nga fshati P. Komuna e V., i lindur me, me nr. personal ish shtetas kosovar, i vdekur me datën, në fshatin P., e cila përbëhet nga pasuria e paluajtshme dhe atë parcelat kadastrale të evidentuara në certifikaten e pronësisë nr.18-1367/19 e datës 26.05.2020.

- P-70202053-00700-3, me sipërfaqe prej 2838 m², në vendin e quajtur Livadhe/Sh. Vir, Zona Kadastrale P.,
- P-70202053-00712-3, me sipërfaqe prej 4257 m², në vendin e quajtur Livadhe/K. Brod, Zona Kadastrale P.,
- P-70202053-00851-1, me sipërfaqe prej 1131 m², në vendin e quajtur S., Zona Kadastrale P.
- P-70202053-00851-2, me sipërfaqe prej 1022 m², në vendin e quajtur S. Zona Kadastrale P.

- P-70202053-01007-3, me sipërfaqe prej 2480 m², në vendin e quajtur B., Zona Kadastrale P.,
- P-70202053-01076-3, me sipërfaqe prej 1740 m², në vendin e quajtur B./B. S. Zona Kadastrale P.
- P-70202053-01167-1, me sipërfaqe prej 1610 m², në vendin e quajtur K./M. V., Zona Kadastrale P.
- P-70202053-01168-1, me sipërfaqe prej 598 m², në vendin e quajtur K./M. V., Zona Kadastrale P.
- P-70202053-01259-1, me sipërfaqe prej 2024 m², në vendin e quajtur K./M. G., Zona Kadastrale P.,
- P-70202053-01259-4, me sipërfaqe prej 2325 m², në vendin e quajtur K./M. G. Zona Kadastrale P.,
- P-70202053-01505-3, me sipërfaqe prej 878 m², në vendin e quajtur B./B., Zona Kadastrale P.,
- P-70202053-01546-2, me sipërfaqe prej 2048 m², në vendin e quajtur Z. Zona Kadastrale P.
- P-70202053-01546-6, me sipërfaqe prej 801 m², në vendin e quajtur Z. Zona Kadastrale P.
- P-70202053-01568-3, me sipërfaqe prej 5214 m², në vendin e quajtur Z. Zona Kadastrale P.

SHPALLEN TRASHËGIMTAR LIGJOR

1. J. R., i biri i trashëgimlënësit A. Z. R., i lindur me ..., me nr. personal ..., nga fshati P., Komuna e V. në pjesën ideale prej 1/2 të pasurisë së paluajtshme të cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

2. B.R., mbesa e trashëgimlënësit A. Z. R, e lindur me ... me nr. personal ... nga fshati P., Komuna e V. në pjesën ideale prej 1/2 të pasurisë së paluajtshme, të cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Propozuesja B. R. nga fshati P. Komuna e V., përmes të autorizuarit të saj, av. Ruzhdi Maloku nga Vushtrria, ka parashtruar propozim për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pas vdekjes së paraardhësit-gjyshit të saj A. R. ish nga fshati Prelluzhë, Komuna e Vushtrrisë. Ka shtuar se sipas dëshmisë së vdekjes se datës 05.05.2021, personat që mund të thirren në trashëgimi janë D.K., J. R., G. M. I. M., M. M., V. M., B. R., M. R., S. R. dhe S. M.

Gjykata më datë 28.03.2022 ka caktuar seancën për shqyrtimin e trashëgimisë, në të cilën trashëgimtarët J. R (i biri i trashëgimlënësit) dhe B. R. (mbesa e trashëgimlënësit), të cilët pasi që janë njoftuar me të drejtat e tyre trashëgimore dhe se deklarata trashëgimore është pa revokueshme, të njëjtit deklaruan se marrin pjesë në masën trashëgimore të të ndjerit A. R. dhe se nuk ua mohojnë të drejtën në trashëgimi edhe trashëgimtarëve të tjerë ligjor. Trashëgimtarët e tjerë M. R. S. R., S. R., V. M., G. Mi. dhe M.M., kanë deklaruar se nuk marrin pjesë në masën trashëgimore të trashëgimlënësit, që iu takon sipas ligjit, ndërsa nuk ua kundërshtojnë të drejtën në trashëgimi. trashëgimtarëve të tjerë ligjor.

Gjykatës më datë 06.05.2022, pa ftesë i ka prezantuar trashëgimtari I. M., i cili ka deklaruar se nuk merr pjesë në masën trashëgimore të trashëgimlënësit që i takon sipas ligjit, ndërsa nuk ua

mohon të drejtën trashëgimtarëve të tjerë ligjor në trashëgimi dhe se ka hequr dorë nga e drejta në ankesë.

Në seancën e datës 03.11.2022 ka prezantuar trashëgimtari J.R., i cili gjykatës ia ka prezantuar Procesverbalin noterial me nr.OPU:298-2022 të noterit J. V., në të cilin përfshihet deklarata e trashëgimtares D. K. e cila ka deklaruar se e pranon pjesën e trashëgiminë që i takon sipas ligjit, por që këtë pjesë ia lë vëllait të tij-trashëgimtarit J. R.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit dhe provave të bashkangjitura dhe deklarimit të trashëgimtarëve në seancat gjyqësore, vendosi që propozimi është i bazuar dhe shpalli trashëgimtarët si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat e konform nenit 11, 12, 130 par 1 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës dhe nenit 171 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CT.nr.05/21, me datë 13.02.2023

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.